



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PËRDORIMIT TË HAPËSIRAVE  
PUBLIKE NË BASHKINË SHKODËR”.

**Konsultim publik :** I hapur

**Data :** 23.04.2025

**Ora :**13:30

**Vendi:** Salla e Këshillit bashkiak

**Numri i pjesëmarrësve :** *Numri i pjesëmarrësve 19, nga të cilët 3 gra.*

**Titulli i projekt-aktit që konsultohet :** “Për miratimin e rregullores së përdorimit të hapësirave publike të Bashkisë Shkodër”.

**Pjesëmarrës :** Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër, banorë dhe grupe interes. (Bashkëngjitur listë prezenca).

**Takimi drejtohet nga Zëvendëskryetari i Bashkisë Shkodër Z.Alban Preka, i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- ✦ Projekt-aktin e propozuar ;
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik;
- ✦ Shtroi pyetje konkrete për pjesëmarrësit;
- ✦ Dha informacion mbi mënyrën e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve për të shprehur mendimet dhe sugjerimet e tyre.

**Pjesëmarrësit që kontribuan në diskutim dhe dhanë rekomandimet e tyre mbi çështjen e trajtuar janë si më poshtë::**

Fjalën e merr **Z. Mashi**, drejtor i drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Shkodër. Ai bën një prezantim të detajuar të projekt vendimit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër.

Në vijim fjala i jepet të pranishmëve.

**Z. H.Palushani**, tregtar në Tregun Rus, bën me dije se është ai personi që ka depozituar dy kërkesa lidhur me projekt rregulloren, që është objekt diskutimi në këtë konsultim. Së pari ai falënderon Këshillin Bashkiak dhe Bashkinë Shkodër për mundësinë që u është dhënë për të paraqitur mendime dhe propozime që ato i konsiderojnë të arsyeshme dhe të nevojshme. Ai vlerëson se kjo

Pr/rregullore zgjidh shumë problematika dhe rregullon shumë parregullsi që ato hasin çdo ditë si tregtarë, por nga ana tjetër nuk u zgjidh atyre si tregtarë të zonës së Rusit një problem në lidhje me ekzpozimin e mallrave që tregtojnë. Citon këtu nenin 3 të kësaj rregulloreje, pika b, “ekspozimi i mallrave jashtë njësisë të tregtimit”. Në fillim, u gëzova sepse mendova që më në fund po marrin përgjigje të gjitha kërkesat tona ndër vite, por kur lexova nenin 37, kuptova që kjo pr/rregullore trajton specifikisht vetëm rastet e subjekteve si bare, kafene në zona të caktuara të qytetit edhe pse disa prej tyre nuk i plotësojnë parametrat e lejuar.

Ai mendon se tek ky nen nuk duhet të kishte vetëm katër kategori të caktuara, lule, fruta dhe suvenire por duhet të përfshihen edhe veshjet. Për më tepër kërkon të dijë se cilave bashki i jeni referuar, pasi në bashki të tjera si ajo e Lezhës, Tiranës nuk e pengojnë ekzpozimin e veshjeve. Ai shpreson shumë që kjo pr/rregullore të shërbejë realisht për të rregulluar çështjet që lidhen me ushtrimin e tregtisë në hapësirat publike, por në këtë rast duhet patur parasysh edhe zona ku kjo pr/rregullore do gjejë zbatim sepse zona e Rusit p.sh ka tjetër mënyrë tregtimi, pasi është pak a shumë si kulturë e asaj zone ekzpozimi i mallit përjashta, pasi blerësi kërkon ta shoh, ta prekë produktin. Në rastin tonë është klienti ai që “vendos” mënyrën tonë të tregtimit.

Ai shton po ashtu se ai ka bërë shumë herë kërkesa për leje dhe i janë refuzuar, pasi pritej kjo rregullore, me kriteret e reja. Për më tepër në zonën e Rusit në përgjithësi kemi dyqane veshjesh dhe kjo rregullore na dëmton pasi prishet kështu tipologjia e bizneseve tona dhe të mos harrojmë që klientela jonë është më së shumti nga Malësia e Madhe, të cilët po largohen dita-ditës dhe për ne kjo rregullore do ishte tjetër penalitet. A e prishin estetikën e zonës apo qytetit frutat dhe perimet më pak se ekzpozimi i një manekini?

Përgjigjet për këtë **Z.Mashi**, duke thënë se kjo pr/rregullore nuk është e detajuar për zona të caktuara, kjo është për të gjithë qytetin. Pjesa e bareve dhe kafeterive që ju përmendet është e mbështetur në ligje dhe nuk është përmendur rastësisht, kurse lidhur me nenin nr.37, kategoritë e përmendura janë përzgjedhur për pamjen estetike, që kanë impaktin më minimalist tek pjesa urbane. Përsa që i përket zonës së Rusit, mendoj që është pak edhe kulturë e vendosur nga vetë tregtarët ekzpozimi i mallit përjashta njësive të tyre të tregtimit dhe se me këtë rregullore do kishte kushte të barabarta. Ashtu si kemi tregun e fruta – perimeve mund të kemi në të ardhmen edhe një treg të mirëfilltë për rrobat. Megjithatë çdo kërkesë apo propozim i ardhur është i mirëpritur dhe do merret në konsideratë. Kjo na bën ne të rivlerësojnë edhe njëherë dhe ta rishohim këtë pr/rregullore.

Përsëri **Z. H.Palushani** shprehet se meqënëse shfrytëzimi i hapësirës publike është një e drejtë dhe jo privilegj, atëherë kjo e drejtë duhet t’i jepet të gjithë njësive tregtare në mënyrë të barabartë. Ai shton se ai ka depozituar një peticion në sekretarinë e Bashkisë Shkodër, pasi kjo sallë duhet të ishte mbushur plot sepse ai sot po flet në emër të të gjithë tregtarëve të Rusit, por ishte e pamundur që ato të mbyllnin bizneset e tyre për të qenë sot prezent dhe për tu dëgjuar edhe zëri i tyre. Ai kërkon sot edhe në emër të tyre që stafi i Bashkisë duhet të rishikojë edhe njëherë nenin 37. Gjithsesi ai thotë se është e vërtetë se estetika e qytetit është e rëndësishme por kjo duhet të shkojë krahas nevojave ekonomike/sociale të qytetarëve.

Fjalën e merr **Z.Gjovalin Premçi**, tregtar tek “Sahati”, i cili përveç artikujve të tjerë tregton edhe biçikleta. Ai shprehet se për biçikletat që parkohen pranë bizneseve, si bare etj, është parashikuar vendosja e “vendparkimit” të tyre. A është e mundur, pyet ai që edhe ne si tregtar të na jepet leje

për të vendosur një vend të tillë duke qënë se jemi edhe qyteti i biçikletave. Ai beson se tek ne si tregtarë çalojnë shumë gjëra, jo vetëm estetika e qytetit. Nuk po flasim për luks, por për bukën e gojës. Duhet të ketë një grup pune që vlerëson në terren. Ne po kërkojmë të na jepet mundësia edhe kundrejt pagesës.

Përgjigjet përsëri **Z. Mashi** duke thënë se lidhur me biçikletat është e cituar tek neni 57-58 i pr/rregullores, ku janë parashikuar kriteret e vendosjes edhe procedurat e marrjes së lejes për këtë. Besoj që nuk është ngarkesë për subjektet e interesuara plotësimi i kriterëve të parashikuara. Kurse përsa i përket pyetjes tjetër janë mbajtur shënime propozimet tuaja dhe do vlerësohen nga ana jonë.

**Z. E. Zalli**, shprehet se edhe në Paris janë të ekspozuara veshjet dhe nuk besoj se në Shkodër kjo prish estetikën e qytetit.

**Zëvendëskryetari Z. Preka** thekson faktin që është bërë një punë shumë voluminoze nga stafi, por detyrimisht falë kësaj seance, propozimet dhe kërkesat tuaja do vlerësohen dhe do mundohemi t'i përmbushim gjithmonë në të mirë të qytetarëve të Shkodrës dhe të vetë qytetit. Do shihet mundësia e përshtatjes dhe përfshirjes aq sa na lejon një rregullore e tillë.

**Z. Sh. Zdrukthi**, tregtar në Rus, shprehet se më përpara një grup pune ka dalë në terren dhe ka verifikuar nga afër punën dhe ai beson se kjo është mënyra më e mirë, që ata të mos penalizohen më vonë dhe të mos lihet vend për abuzime. Qyteti jonë, shton ai, me këtë lloj biznesi jeton sepse nuk ka shumë mundësi të tjera. Ka patur raste që edhe jemi gjobitur padrejtësisht për këtë prandaj ai kërkon që të verifikohet situata para se të arrihet në konkluzione që do të dëmtonin tregtarët.

Përsëri **Zëvendëskryetari Z. Preka**, sqaron se siç u tha edhe më sipër, ne jemi të hapur për bashkëpunim dhe prandaj u mbajt dhe kjo dëgjese publike. Të gjitha kërkesat, propozimet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëpritura, që të arrihet në një produkt final që t'iu shërbejë ju sa më shumë. Për më tepër, ju i keni duert e hapura për çdo abuzim që mund t'iu bëhet në çdo aspekt. Ai falënderon edhe njëherë të gjithë të pranishmit, për prezencën dhe çdo sugjerim që dhanë lidhur me këtë pr/rregullore.

*Pyetje dhe diskutime të tjera nga të pranishmit nuk ka. Dëgjesa për "Për miratimin e rregullores së përdorimit të hapësirave publike, Bashkisë Shkodër", deklarohet e mbyllur.*

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**

**Mbajtësi i procesverbalit:**

**Irma Sulishti**

